



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim (B-A)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 25 leksione /15 seminare
Viti / Semestri : Viti III , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Të njohë studentët me Përkthimin duke ofruar një panoramë të gjerë të nocioneve, koncepteve, ideve, teorive, qasjeve kryesore. Të mësojë studentët të zhvillojnë mendimin kritik gjatë analizës së metodave dhe strategjive të ndryshme që mund të vihen në jetë gjatë procesit të përkthimit duke i mbudhur ata drejt ndërtimit të strategjisë vetjake përkthimore. Të bëjë të mundur përvetësimin e një deontologjie personale nga ana e studentëve nisur nga parimet e përgjithshme të etikës profesionale të profesionit të përkthyesit.

Objektiva specifike lëndore:

Studenti duhet të dijë se si të:

- 1.Të mendojë në mënyrë kritike në lidhje me konceptet, teoritë e ndryshme të përkthimit.
- 2.Të identifikojë dhe të emërtojë problemet përkthimore të teksteve të llojeve të ndryshme, të parashikojë zgjidhje të ndryshme, të vendosë duke arsyetuar në lidhje me këto zgjedhje.
- 3.Të njihet me metodat dhe strategjitë e procesit të përkthimit.
- 4.Të referojë e të bëjë të njohur rezultatet e punës së tij.

Rezultate të pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë:

- 1.Të zhvillojnë kompetencën e të reflektuarit në mënyrë kritike në lidhje me përkthimin dhe sfidat e tij;
- 2.Të ushtrojnë mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ duke prodhuar një argumentim të arsyetuar në lidhje me aktin e të përkthyerit;
- 3.Të bëjnë lidhjen mes teorisë dhe praktikës së veprimtarisë përkthimore;
- 4.Të njihen me profesionin e përkthyesit dhe rolin e tij të pazëvendësueshëm në shoqërinë vendase e ndërkombëtare.
- 5.Të zhvillojnë kompetencën ndërkulturore duke u ndërgjegjësuar për përkthimin dhe përkthyesin si mjet i ndërtimit të urave mes popujve në një kontekst plurikulturalizmi, ndërkulturalizmi dhe diversitetit kulturor.